



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT  
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 1026/<sup>6</sup> Prot

Tiranë, më 01 . 7 .2022

VENDIM

Nr. 19 , datë 01 . 7 .2022

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesja, znj. ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 1026 Prot., datë 20.05.2022, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”, kundër Autoritetit Publik “Banka e Shqipërisë” (në vijim quajtur “Autoriteti Publik”).

Ankuesja, në cilësinë e kërkueses, nëpërmjet e-mail-it datë 04.05.2022, ka kërkuar t’i vihet në dispozicion informacioni/dokumentacioni, lidhur me:

1. *Vendimin së bashku me argumentimin e organit që miratoi buxhetin e fondit të prokurimit të rikonstruksionit të ish-Hotel Dajtit në momentin që u çel procedura e prokurimit. (Përveç vendimit të Këshillit Mbikqyrës që është publik, vendimi i cili uli fondin nga 18 në 16 milion euro.)*
2. *Mënyrën se si u përzgjodhën kompanitë të cilat morrën pjesë në garën për rikonstruksionin e ish- Hotel Dajtit.*
1. *Numrin, emrin dhe ofertën financiare të kompanive pjesëmarrëse në garën e rikonstruksionit të ish- Hotel Dajtit.*
3. *Kopje të kontratës së nënshkruar me kompaninë e kontraktuar në përfundim të procedurës së prokurimit të rikonstruksionit të ish- Hotel Dajtit.*

4. *Argumentimin se çfarë ngjarjesh kanë vonuar në mospërmbushjen e detyrimeve kontraktuale për përfundimin brenda 3 vjetësh të punimeve të rikonstruksionit të ish -Hotel Dajtit.*
5. *Penalitete të kompanisë për vonesat nëse janë vendosur.*
6. *Parashikimi se kur do të përfundojë totalisht rikonstruksioni i ish- Hotel Dajtit.*
7. *Kosto që Banka e Shqipërisë ka paguar shtesë për godinat që ka me qira në mungesë të bërjes funksionale të ambienteve pranë ish –Hotel Dajtit.*

Autoriteti Publik, me shkresën nr. 2127 Prot., datë 17.05.2022 i ka kthyer përgjigje ankueses duke cituar se: *“...Informacioni i kërkuar është i një natyre sensitive dhe të dhënat në përmbajtjen e tij janë informacion jo publik, i klasifikuar “sekret bankar/profesional”.*

Ankuesja, pas përgjigjes së sipërcituar, pretendon se nuk i është vënë në dispozicion dokumentacioni i kërkuar sipas objektit të kërkesës për informacion. Ndodhur në këto kushte, ankuesja i është drejtuar Zyrës së Komisionerit me ankesë, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit si dhe urdhërimin e dhënies së dokumentacionit nga autoriteti publik.

Komisioneri, pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa është në përputhje me përcaktimet e nenit 24 të ligjit nr.119/2014, “Për të drejtën e informimit” (në vijim “LDI”) dhe ankuesja legjitimohet në kërkimin e saj.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur”*, Komisioneri, me shkresën nr. 1026/1 prot., datë 24.05.2022, kërkoi nga Autoriteti Publik, të rivlerësojë dhënien e informacionit/dokumentacionit të kërkuar në përputhje me vendimmarrjen e Komisionerit për raste të ngjashme.

Autoriteti Publik me shkresën nr. 2241/1 Prot., datë 27.05.2022, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 1026/2 Prot., datë 31.05.2022, ka kthyer përgjigje duke bërë me dije se: *“Qëndrimi i Bankës së Shqipërisë në lidhje me objektin e kërkesës për informacion mbetet i pandryshuar, pra është në përputhje me aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë klasifikimin dhe dhënien e informacionit të klasifikuar në bankë”.*

Në vijim, me emailin e datës 02.06.2022, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr.1026/4 Prot., datë 03.06.2022, ankuesja ka vijuar ankimin duke kërkuar vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar.

Me qëllim marrjen e një vendimi të drejtë dhe objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të LDI, në të cilin parashikohet se: *“...me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e*

*Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ... kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve”, bazuar dhe në nenin 87 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri me shkresën nr. 1026/5 Prot., datë 13.06.2022 ftoi palët në një seancë dëgjimore, me datë 22.06.2022.*

Seanca u zhvillua me prezencën e përfaqësuesit të dërguar nga ankuesja dhe përfaqësuesve të Autoritetit Publik, znj. Najada Samarxhi, me detyrë Koorditore për të drejtën e informimit, z. Artur Baboci, Zëvendës drejtor në Departamentin e Administrimit, znj. Alba Fagu, Përgjegjës Sektori në Departamentin Juridik, z. Kristino Kromidha, Specialist në Departamentin Juridik.

Gjatë seancës dëgjimore, ankuesi rikonfirmoi qëndrimin e reflektuar në ankesë. Ndërkohë, znj. Samarxhiu, në cilësinë e koorditores për të drejtën e informimit pranë Autoritetit Publik, rikonfirmoi qëndrimin e Autoritetit Publik për mosdhënien e informacionit të kërkuar, duke deklaruar ndër të tjera se: “...e vlerëson të panevojshme zhvillimin e kësaj seance dëgjimore, pasi qëndrimi i Bankës së Shqipërisë është i konsoliduar dhe përfundimtar”, në kundërshtim të plotë kjo me nenin 78 “Bashkëpunimi gjatë hetimit administrativ” të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative, si dhe me vet thelbin e rolit të koordinatorit për të drejtën e informimit pranë autoritetit publik. Konkretisht, neni 10 i LDI, përcakton koordinatorin për të drejtën e informimit si subjektin përgjegjës brenda autoritetit publik për zbatimin e ligjit dhe garantimin e të drejtës për informim, duke i mundësuar cdo kërkuesi të drejtën për t’u njohur me informacion publik.

Sa i përket përfaqësuesve të tjerë të Autoritetit Publik të pranishëm në seancë, u shprehën duke dhënë sqarimet e nevojshme në lidhje me pikën 1, 5 dhe 6 të kërkesës për informacion.

Pas zhvillimit të seancës, ankuesja ka vijuar ankimin me emailin e datës 29.06.2022, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 1026/6 Prot., datë 30.06.2022, duke konsideruar të ezauruara përgjigjet për pikat 1, 5 dhe 6, si dhe duke kërkuar dhënien e informacionit për pikat 2, 3, 4, 7 dhe 8 të kërkesës për informacion.

Në këto kushte, nga verifikimi i dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, provave dhe argumentave të palëve, Komisioneri vlerëson se, argumentet e paraqitura nga Autoriteti Publik me shkresën nr. 2241/1 Prot., datë 27.05.2022 për mosvënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar, konfirmuar dhe gjatë seancës dëgjimore, nuk janë në përputhje me dispozitat dhe parimet e LDI, si dhe detyrimet që burojnë nga ky i fundit.

Në lidhje me argumentin e parashtruar nga Autoriteti Publik, sipas së cilit: “*Informacioni i kërkuar është i një natyre sensitive dhe të dhënat në përmbajtje të tij janë informacion jo publik, i klasifikuar “sekret bankar/profesional”*”, Komisioneri vlerëson se, ky argument nuk qëndron, pasi terminologjia “*Sekret Bankar*” e përdorur nga Autoriteti

Publik nuk gjen rregullim të posaçëm në ligjin nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në gjithë kuadrin nënligjor të dalë në zbatim të tij.

Gjithashtu, në nenin 2 të rregullores “Për procedurat e prokurimit në Bankën e Shqipërisë”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikqyrës nr. 81, datë 15.11.2006, i ndryshuar parashikohen parimet kryesore mbi bazën e të cilave kryhen procedurat e prokurimit nga Autoriteti Publik. Në pikën “d” të këtij neni parashikohet “*parimi i sigurimit të ndershmërisë, besimit të publikut dhe të arritjes së transparencës në procedurat e prokurimit në Bankën e Shqipërisë*”.

Gjatë procesit të hetimit administrativ Autoriteti Publik nuk provoi në asnjë moment, se në cilën pikë të nenit 17 të LDI e mbështet qëndrimin e tij lidhur me mosvënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar, pasi është ky nen, i cili parashikon mundësinë e kufizimit të të drejtës për informim, shkaqet dhe arsyet që mund të çojnë një autoritet publik për të kufizuar të drejtën për informim, si dhe rastet përjashtimore nga ky rregullim. Në pikën 6 të këtij neni, parashikohet se: “*...Autoriteti publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim*”. Bazuar në këtë parashikim, Autoriteti Publik duhet të kishte vlerësuar individualisht çdo pikë të kërkesës për informacion, duke provuar dhe argumentuar mbi cilën pikë të nenit 17 bazohet kufizimi i informacionit, vlerësim i cili nuk rezulton të jetë bërë. Për rrjedhojë, Autoriteti Publik nuk mund të bazojë kufizimin e një të drejte kushtetuese, vetëm mbi argumentin se “*Informacioni i kërkuar është i një natyre sensitive dhe të dhënat në përmbajtje të tij janë informacion jo publik, i klasifikuar “sekret bankar/profesional*”.

Në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 2 të LDI parashikohet se: “*Autoritet publik*” është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësive të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj”. Në kuptim të këtij parashikimi, Banka e Shqipërisë është Autoritet Publik dhe subjekt i LDI, për rrjedhojë detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Për të mundësuar realizimin e objektit dhe qëllimit të tij, LDI, në nenin 1 përcakton se: “*1. Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. 2. Rregullat e parashikuara në këtë ligj kanë për qëllim garantimin e njohjes së publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit e të shoqërisë. 3. Ky ligj ka për qëllim edhe nxitjen e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike.*”

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se, pavarësisht legjislacionit të aplikueshëm për zhvillimin e procedurave të kontraktimit, si dhe përjashtimit të Autoritetit Publik nga zbatimi i Ligjit për prokurimin publik, ky fakt nuk passjell përjashtimin e këtij autoriteti nga zbatimi i LDI, pasi ky i fundit ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, të

transparencës e të përgjegjshmërisë së Autoriteteve Publike dhe çdo subjekti tjetër jo shtetëror, që ushtron funksione publike.

Nga praktikata e administruara nga Komisioneri, konstatohet se qëndrimi i mësipërm është i përsëritur nga Autoriteti Publik edhe pse Zyra e Komisionerit ka krijuar një praktikë të konsoliduar përmes vendimmarrjeve për raste të ngjashme, vendimmarrje të cilat kanë mbetur në fuqi edhe nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, informacioni/dokumentacioni i kërkuar përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të LDI, sipas të cilit *“informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik*”.

Në këtë kuptim, personi përgjegjës duhet të procedoj me vënie në dispozicion të kërkuësës të informacionit/dokumentacionit, i cili është prodhuar ose mbahet nga Autoritetit Publik në formën e zotëruar.

Pas shqyrtimit në tërësi të provave, sa i përket përgjegjësisë për refuzimin e dhënies së informacionit, nga verifikimi i dokumentacionit administruar gjatë procesit të hetimit administrativ, si dhe deklarimit në seancën dëgjimore, Komisioneri konstaton se, znj. Najada Samarxhiu, me detyrë Koordinatore për të drejtën e informimit pranë Autoritetit Publik ka refuzuar dhënien e informacionit/dokumentacionit duke mos përmbushur kompetencat e saj të parashikuara në nenin 10 të LDI, konkretisht, shkronja a) e pikës 2 përcakton se, *Koordinatori i mundëson çdo kërkuesi të drejtën për t'u njohur me informacionin publik, sipas këtij ligji, duke u konsultuar me dokumentin origjinal ose duke marrë një kopje të tij.*

Në këto kushte, bazuar në shkronjën “a” të pikës 2 të nenit 18 të LDI, *refuzimi për dhënien e informacionit, në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë e cila varion nga 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) Lekë deri në 300.000 (treqind mijë) Lekë.*

Bazuar në pikën 3 të nenit 19, të LDI, Koordinatorin për të drejtën e informimit ka përgjegjësi administrative, sipas parashikimeve të këtij ligji, për kundërvajtjet administrative të parashikuara në shkronjën “a” të pikës 2, të nenit 18 të këtij ligji.

Si përfundim, Komisioneri thekson se, e drejta për informim, bën pjesë në grupin e të drejtave themelore të njeriut, të mbrojtura posaçërisht nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ), e cila ka për qëllim t'i garantojë publikut njohjen me informacion në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë.

Në pikën 2 të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikohet se: *“Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore...”*. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

## PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në shkronjën a) të pikës 2 të nenit 18, pikën 3 të nenit 18, pikën 2 dhe 3 të nenit 19, pikat 1 dhe 2 të nenit 21, nenin 22, shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

## V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës së znj. \_\_\_\_\_, nr. 1026 Prot., datë 20.05.2022, ndaj Autoritetit Publik “Banka e Shqipërisë”, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit sipas kërkesës për informacion datë 04.05.2022, konkretisht: (2. Mënyrën se si u përzgjedhën kompanitë të cilat morrën pjesë në garën për rikonstruksionin e ish- Hotel Dajtit. 3. Numrin, emrin dhe ofertën financiare të kompanive pjesëmarrëse në garën e rikonstruksionit të ish- Hotel Dajtit. 4. Kopje të kontratës së nënshkruar me kompaninë e kontraktuar në përfundim të procedurës së prokurimit të rikonstruksionit të ish- Hotel Dajtit. 7. Parashikimi se kur do të përfundojë totalisht rikonstruksioni i ish- Hotel Dajtit. 8. Kosto që Banka e Shqipërisë ka paguar shtesë për godinat që ka me qira në mungesë të bërjes funksionale të ambienteve pranë ish –Hotel Dajtit), brenda datës 8 . 7 .2022.
3. Dënimin e znj. Najada Samarxhiu, me detyrë Koordinatore për të drejtën e informimit pranë Autoritetit Publik, në cilësinë e personit përgjegjës, me gjobë në vlerën 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, në përputhje me nenin 19, pika 2 dhe 3 e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Masa e dënimit me gjobë, shlyhet me këste mujore. Gjoha ekzekutohet nga Drejtoria e Financës së Autoritetit Publik brenda 6 muajve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Kundër vendimmarrjes në pikat 1, dhe 2, palët kanë të drejtën e ankimit brenda 45 ditëve në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në përputhje me nenin 25 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
5. Kundër vendimmarrjes në pikën 3, personi ndaj të cilit është vendosur sanksioni administrativ, ka të drejtën e ankimit brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit të vendimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në përputhje me nenin 22 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
6. Ky vendim u shpall sot në datë 01 . 7 .2022.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

